



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.Anr.302/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Kujtim Pasuli - kryesues, Skender Çoçaj dhe Ramush Bardiqi- anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Klinë, të paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të parregullsive në Qendrën e Komunale të Numërimit (QKN) për Zgjedhjet Lokale, të mbajtura më datë 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur me 24.10.2025, merr këtë:

V E N D I M

REFUZOHET E PABAZUAR ankesa ZL.Anr.302/2025, e datës 22.10.2025, e parashtruar nga Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Klinë, e paraqitur kundër Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të parregullsive në Qendrën e Komunale të Numërimit (QKN), për Zgjedhjet Lokale, të mbajtura më datë 12 Tetor 2025.

A r s y e t i m

Me datën 22.10.2025, PZAP-i përmes postës ka pranuar ankesën nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Klinë, në të cilën pretendon se me datën 12.10.2025, në shkollën fillore "Ali Krasniqi", në fshatin Ujmirë, komuna e Klinës, vendvotimi me nr. identifikues 0805 01, sipas vëzhguesve dhe komisionerëve të Partisë Demokratike të Kosovës janë evidentuar shkelje të procesit zgjedhorë të cilat janë në kundërshtim me Ligjin për Zgjedhjet e përgjithshme të Republikës së Kosovës, si dhe me Rregulloren e Komisionit Qendror Zgjedhor.

Shkeljet janë bërë ashtu që në kutitë e votimit me nr.identifikues 0805 01, në këtë qendër të votimit, disa vota të Partisë Demokratike të Kosovës janë shpallur të pavlefshme ndërkohë që të njëjtat kanë qenë të vlefshme konform dhe në pajtim me të gjitha dispozitat e ligjeve në fuqi.

Shkelje tjetër e evidentuar në po të njëjtën qendër të votimit, të cilat janë vërejtur nga vëzhguesit e PDK-së, në atë mënyrë që disa vota të cilat janë gjendur në kutitë e votimit janë të pavulosura dhe i takonin Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, gjithashtu në po të njëjtat kuti janë gjendur më shumë vota për kandidatin me nr.2 nga lista e AAK-së se sa në të vërtetë kishte nënshkrime në regjistër, pra ka pasur shkelje flagrante të procesit zgjedhor duke u evidencuar më shumë vota se sa që ishin të evidencuara dhe të nënshkruara në regjistrin e KQZ-së, duke krijuar dyshimin e bazuar për manipulimin e votave.

PDK-dega në Klinë konsideron se shpallja e pavlefshme e votave është bërë pa ndonjë bazë ligjore dhe pa argumentim të mjaftueshëm dhe në kundërshtim me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe rregulloret e KQZ-së, ndërsa raporti për gjetjen e disa votave të pavulosura përbën shkelje të pa precedentë të procesit të drejtë zgjedhor dhe bie ndesh me nenin 113 të

Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, i cili garanton se numri i votuesve duhet të përputhet me numrin e votuesve të regjistruar në listën përkatëse.

Gjithashtu votat janë shpallur të pavlefshme pa ndonjë verifikim të qartë dhe të arsyetim të dokumentuar në procesverbal.

Procedura e numërimit nuk është përcjellë me transparencë, dhe sipas vëzhguesve dhe të gjitha provave të disponueshme, votat e shpallura të pavlefshme janë hedhur në mënyrë të rregullt dhe të vlefshme nga votuesit.

Kjo përbën shkelje të së drejtës për votim, si dhe barazisë së garës zgjedhore, duke ndikuar drejtpërdrejtë në rezultatin përfundimtar, për të cilat shkelje është njoftuar edhe Policia, në vendngjarje ishte edhe Prokurori i Shtetit si dhe hetuesit ndërkombëtarë të cilët kanë iniciuar procedurën penale,

Si provë ka bashkangjitur kopje të procesverbalit nga vendvotimi përkatës; Fotografi nga numërimi, Raporte dhe deklarata me shkrim nga vëzhguesit,

Kërkojnë nga PZAP-i, që pas vlerësimit të pretendimeve nga kjo ankesë dhe shqyrtimit të gjendjes të marrë këtë vendim të APROVOHET si e bazuar ankesa, të konstatohet se shpallja e pavlefshme e votave në vendvotimet e lartcekura është bërë në kundërshtim me ligjin, të urdhëroj rivlerësimin dhe rinumërimin e votave të shpallura të pavlefshme, të kërkoj nga KQZ korrigjimin e rezultateve në përputhje me votat e vlefshme, të kërkoj hetim të plotë nga KQZ për origjinën e votave të tepërta, të shpallë të pavlefshëm rezultatin e këtij vendvotimi nëse konfirmohet manipulimi.

Në përgjigjen në ankesë të Komisionin Qendror të Zgjedhjeve – KQZ, sqaron se lidhur me pretendimet e palës në ankesën ZL.A.nr. 302/2025, të Subjekti Politik "PDK, pas analizimit të lëndës, ka konstatuar se ankesa është paraqitur jashtë afatit ligjor për paraqitjen e ankesës, në kuptim të nenit 119, paragrafi 1, të LZP, personi i cili ka interes ligjor në një çështje brenda juridiksionit të PZAP-së, ose të drejtat e të cilit janë shkelur për sa i përket procesit zgjedhor të rregulluar sipas këtij ligji ose rregullave zgjedhore, mund të parashtrojë ankesë në PZAP brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i mbylljes së qendrës së votimit.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashpresa - PZAP, pas shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të lëndës, pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë gjeti se:

- Ankesa është e pa bazuar.

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës dhe provave të bashkangjitura në përgjigje ankesë të paraqitura nga KQZ-ja, vlerësoj se pretendimet e ankuesit, Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Klinë, janë të pa qëndrueshme dhe të pa bazuara dhe si të tilla i refuzoj për faktin se nga veprimet e përshkruara si në ankesë se në shkollën fillore "Ali Krasniqi", qendta e votimit 0805 01, në fshatin Ujmirë, komuna e Klinës, disa vota të Subjektit Politik PDK, janë shpallur të pavlefshme ndërkohë që të njëjtat kanë qenë të vlefshme, pastaj që disa vota të cilat janë gjendur në kutinë e votimit janë të pavulosura dhe i takonin Subjektit Politik AAK, gjithashtu në po të njëjtat kuti janë gjendur më shumë vota për kandidatin me nr.2 nga lista e AAK-së se nënshkrime të votuesve në regjistër, paneli nuk ka arritur që të vërtetoj se ka pasur shkelje apo parregullsi për të cilat pala ankuese pretendon me ankesën e tij.

Paneli nga provat e bashkangjitura në ankesë nuk ka arritur të argumentoj se ka pasur parregullsi në QV me numër 0805 01, sepse në Formularin e Rezultateve të Subjekteve-FRS për Kuvendet Komunale, pasqyrohet se tek rubrika 5 numri i nënshkrimeve në listën e

votuesve është 288, tek rubrika numër 6 numri i fletëvotimeve të papërdorura është 458, tek rubrika numër 7 numri i fletëvotimeve të dëmtuara është 3, tek rubrika numër 8 numri i fletëvotimeve brenda kutisë se votimit është 289, tek rubrika numër 9 dallimi në mes të rubrikës 5 dhe 8 është 1 fletëvotim, tek rubrika numër 10 numri i fletëvotimeve të pavlefshme, paplotësuara dhe të pavulosura brenda kutisë është 1, tek rubrika numër 11 numri i fletëvotimeve të vlefshme është 275, tek rubrika numër 12 gjithsej fletëvotime të paplotësuara, pa vlefshme dhe të vlefshme është 276, tek rubrika numër 13 gjithsej është 750, si dhe tek rubrika numër 14 dallimi në mes të rubrikës 3 dhe rubrikës 13 është 00. Nga kjo paneli ka gjetur se ka të beje vetëm me një fletëvotim të pavlefshëm që nënkupton se kjo parregullsi e pretenduar është evituar në QKN duke qenë se tek rubrika numër 14 dallimi në mes të rubrikës 3 dhe rubrikës 13 është 00.

Ndërsa sa i për ketë pretendimeve ankimore se në QV 0805 01, janë gjetur më shumë vota për kandidatin me nr.2 nga lista e AAK-së, se sa në të vërtetë që kishte nënshkrime në regjistër, nga provat e bashkangjitura në ankesë si dhe provat nga përgjigjja e KQZ-së, paneli nuk ka arritur që të vërtetoj se ka pasur shkelje tjera të pretenduara në ankesën e ankuesit.

Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se: "Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse", Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë dhe nga provat e ofruara si dëshmi parashtruesi i ankesave nuk ka arritur që të vërtetoj pretendimet e theksuara si më lartë.

Paneli, vlerësoi se ankesa është e pabazuar dhe e pa argumentuar, pasi që provat e bashkangjitura në ankesë nuk janë bindëse, dhe nuk e vërtetuan një gjendje ashtu siç pretendohet se disa vota të Subjektit Politik PDK, janë shpallur të pavlefshme ndërkohë që të njëjtat kanë qenë të vlefshme, pastaj që disa vota të cilat janë gjendur në kutinë e votimit janë të pavulosura dhe i takonin Subjektit Politik AAK, gjithashtu në po të njëjtat kuti janë gjendur më shumë vota për kandidatin me nr.2 nga lista e AAK-së se sa nënshkrime të votuesve në regjistër, me te cilën do të vërtetoheshin këto pretendime.

Duke marrë parasysh të lartpërmendurat, Paneli vlerëson se parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse, edhe pse në bazë të nenit 117 paragrafi 3 të Ligjin Nr.08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në të cilin nen përcaktohet se "*Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse*".

Nga arsyet e theksuara më lartë dhe duke u bazuar në nenin 117 paragrafi 3, lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të Ligjin Nr.08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZLAnr.302/2025 më datën 24.10.2025

Kryesues i Panelit

Kujtim Pasuli

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.